



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 36 , datë 22.05.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE
NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS TROPOJË SH. A**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe në raportin e inspektimit nr. 65/1, datë 17.05.2018, për gatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatoi:

Shoqërisë Ujësjiellës Tropojë sh.a. i ka përfunduar afati i licencës në datën 13.06.2016 dhe ushtron veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë nga Enti Rregullator i Ujit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Shoqëria ka depozituar kërkesën për rilicencim dhe dokumentacionin bashkëlidhur pranë Entit Rregullator të Ujit me Nr. 257/3 Prot, datë 22.05.2018.

Shoqëria Ujësjiellës Tropojë sh.a aplikon tarifë për konsumatorët familjarë për qytetin e Bajram Currit dhe tarifë shërbimi për të gjithë kategoritë e konsumatorëve në kundërshtim me vendimin e KKRR Nr. 29 datë 13.10.2004 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ujësjiellës Tropojë sh.a" si dhe në shkelle të pikës b, të nenit 14 të ligjit Nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masës administrative ndaj Shoqërisë Ujësjiellës Tropojë sh.a. për kundërvajtjen administrative:

a) moszbatimi i vendimeve të Entit Rregullator për tarifat.

2. Shoqëria Ujësjiellës Tropojë sh.a ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës Tropojë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani